

Trajnim në temë “Decentralizimi dhe menaxhimi me bashkësi multietnike”

Më 17 dhe 18 shtator 2008 në Strugë u organizua trajnim në temë “Decentralizimi dhe menaxhimi me bashkësi multietnike” me pjesëmarrës nga Kërçova, Dibra, Qendra Zhupë, Vraneshtica dhe Drugova. Trajnimin e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrat lokale të projektit në Kërçovë dhe Dibër (Qendra për zhvillim e bashkësive Kërçovë dhe Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë në Dibër, ish Qendrat për përkrahje të OJQ-ve).

Në trajnim dominoi teoria me aksent të posaçëm në lëmin e menaxhimit me bashkësi multietnike, kurse në pjesë të veçantë u përpunua procesi i decentralizimit.

Në trajnim u përfshinë temat në vijim: procesi i decentralizimit në RM, menaxhimi me bashkësi multietnike në teori dhe praktikë, praktikimi i fuqisë dhe pushtetit, probleme në nivel lokal dhe koncepte të ndryshme në menaxhimin me bashkësi multietnike në RM dhe në nivel lokal.

Trajnuesit Zhidas Daskalovski dhe Marija Risteska nga Qendra për hulumtim dhe krijimin e politikave Shkup e realizuan trajnimin në praninë e 26 pjesëmarrësve (17 përfaqësues nga organizata joqeveritare nga Kërçova, Dibra dhe Qendra Zhupë, 5 përfaqësues nga institucione në Kërçovë, 2 përfaqësues nga Komunitet e Kërçovës dhe Vraneshticës, 2 përfaqësues nga Këshilli i Komunave të Kërçovës dhe Drugovës). Pjesëmarrësit fituan dituri për procesin e decentralizimit dhe u njoftuan me mënyrën e menaxhimit me bashkësi multietnike.

Ata në mënyrë aktive morën pjesë në trajnim me komentuar dhe mendimet e tyre gjatë ushtrimeve, por edhe gjatë ligjërimeve. Gjatë trajnimit në grup kishte shumë diskutime dhe qëndrime të kundërta, nuk vërehej tendencë e madhe për të kundërshtuar për dallimet, por prandaj ekzistonte dialog konstruktiv – debat.